



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
BORDI DISIPLINOR**

Nr. (•)i Vendimit

**VENDIM
I BORDIT DISIPLINOR**

i përbërë nga :

| | |
|---------------------------------|------------------------|
| Jonida Gaba: | Kryetare |
| Entela Memishaj Shehaj: | Sekretar/Anëtar |
| Irena Laha: | Anëtar |
| Marjana Tutulani Semini: | Anëtar |
| Merita Prifti: | Anëtar |

mori në shqyrtim kërkesën e Ministrit të Drejtësisë nr. (•)Prot., datë (•), regjistruar pranë Bordit Disiplinor më datë (•), me të dhënat si më poshtë:

KËRKUES: Ministria e Drejtësisë

DREJTUAR: Bordi Disiplinor, Dhoma Kombëtare e Noterisë

OBJEKTI: Pezullimi i noterit (•)

BAZA LIGJORE: Neni 56, shkronja "a", neni 57 dhe neni 58, pika 1, të Ligjit Nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

BORDI DISIPLINOR

- menjëherë pas regjistrimit të çështjes, më datë (•), mori në shqyrtim kërkesën e Ministrit të Drejtësisë nr. (•)Prot., datë (•) për pezullimin e noterit (•);
- administroi kopje të Vendimit penal nr.(•), (•), lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor (•), për caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" në ngarkim të noterit z.(•), për kryerjen e veprave penale "Vrasje me paramendim" e mbetur në tentativë si dhe "Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit", të parashikuara nga nenet 78 e 22 dhe 278/1 i Kodit Penal;
- administroi shkresën e drejtuesit të prokurorisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë (•), datë (•), dërguar Ministrisë së Drejtësisë, përmes së cilës konfirmohen gjeneralitetet e personit ndaj të cilit është vendosur masa e sigurimit "arrest në burg", z. (•), i biri i (•) dhe (•), i datëlindjes (•), me numër identifikimi (•) dhe konstatoi se këto gjeneralitete korrespondojnë me ato që përkasin noterit (•), noter i Dhomës së Noterisë (•), me licencë nr. (•), datë (•), sipas dosjes përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë;
- konstatoi përmes shkresës së mësipërme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë (•), datë (•), se masa e sigurimit "arrest në burg" në ngarkim të noterit z. (•) është ekzekutuar më datë (•);

bazuar në nenet 56 – 60 të Ligjit Nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë",

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë;
2. Pezullimin e noterit (•), Noter i Dhomës së Noterisë (•), me licencë nr. (•), datë (•), për gjithë periudhën e kohëzgjatjes së masës së sigurimit “arrest në burg”, në bazë të nenit 56, shkronja “a”, të Ligjit Nr. 110/2018, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”;
3. Vendimi i njoftohet noterit (•) dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë (•);
4. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për nxjerrjen e urdhrit përkatës për zbatimin e këtij vendimi;
5. Ngarkohet Dhoma Kombëtare e Noterisë për publikimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e tij në regjistrin përkatës;
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatën kompetente administrative të shkallës së parë Tiranë, brenda 45 diteve nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi;
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë (•), në Tiranë.

Bordi Disiplinor:

Jonida Gaba

Entela Memishaj Shehaj

Irena Laha

Marjana Tutulani Semini

Merita Prifti